

Ekspozitë e galerisë "EXIT" të Pejës

# "Muaji i mjaltit në Kosovë" - roli i burrit dhe i gruas në martesë

Galeria "EXIT", nga data 30 maj deri më 19 qershor, në kuadër të projektit më të ri të artit pamor me artistet Maja Bajeviq dhe Emanuel Licha, do të zhvillojë disa ligjërata, performime ku në qendër do të jetë ekspozita me titullin "Muaji i mjaltit në Kosovë", krejt kjo e organizuar nga instituti i artit bashkëkohor - "EXIT" me seli në Pejë

ROMA  
MILANO

**MENTOR HALITI**

PRISHTINË, 29 MAJ - Është ekspozita me titullin "Honeymoon in Kosovo" (Muaji i mjaltit në Kosovë) me artistet nga Sarajeva dhe Parisi, përkatësisht Maja Bajeviq dhe Emanuel Licha, do të jenë autorë të ekspozitës provokative, të artit bashkëkohor, të cilin e organizon "EXIT" nga Peja.

Galeria "EXIT", nga data 30 maj deri më 19 qershor, në kuadër të projektit më të ri të artit pamor me artistet Maja Bajeviq dhe Emanuel Licha, do të zhvillojë disa ligjërata, performime ku në qendër do të jetë ekspozita me titullin "Muaji i mjaltit në Kosovë", krejt kjo e organizuar nga instituti i artit bashkëkohor - "EXIT" me seli në Pejë.

"Ideja e projektit ka për qëllim të nënvizojë mashkullin tipik dhe femrën tipike në martesë: burri ndërton shtëpinë, ndërsa gruaja përkujdeset për enterierin", thuhet nga organizatori.

Pasi që është fjala për art, atëherë shtëpia e supozuar është ndryshe nga e zakonshmja.

Projekti është sintezë e dy punimeve dinstinktive: Maja Bajeviq do ta ndriçojë enterierin me një dritë verbuese, duke ndarë të jashtmen me të brendshmen e shtëpisë. Nga jashtë vrimat ndriçuese do ta japin pamjen e dritareve, ndërsa nga brenda nuk do të jetë e mundshme të shihet gjë.

"Gjëja e vetme që do të ndjeni është ajo çka ju dëgjoni dhe nuhatni, por jo edhe çka shihni", thuhet në një deklaratë të organizatorit, të përc-

jellë për media. Tingulli të kujton kolapsin e pullazit, e shtëpisë që shembet në vetevete. Aroma është e asaj që i ngjan tortës së ëmbël. Një përzjerje e të rrezikshmes me të sigurisë mu si në martesë, si në shtëpi. Emanuel Lich do ta mbulojë shtëpinë e përmbytur nga jashtë me copa gazetash, duke mos i mbuluar vrimat, por duke dekoruar rreth vrimave. Këto copa gazetash të ngjitura në mure të shtëpisë janë e vetmja gjë që mbetet pas, kur e njëjta shtëpi braktiset. E vetmja që dëshmon për prezencën e dikurshme të njerëzve që kanë jetuar aty.

"Ky projekt bashkëprodhues kap dy dimensionet e të jetuarit në Kosovë; nga njëra anë, bashkëjetesën mes dy njerëzve dhe kulmin e shtëpisë së njëjtë që gjithmonë do të rëndojë mbi kokat e tyre, nga ana tjetër".

Manifestimi artistik do të nisë me laboratorin e ashtuquajtur të arteve vizuale, në kuadër të së cilës do të ligjërojnë Maja Bajeviq dhe Emanule Licha. Në ditët pasuese, më 4 korrik, këto dy autore do të perforojnë në Pejë, në gjimnazin "Bedri Pejani", ndërsa projekti do të përmbyllet me ekspozitën "Honeymoon in Kosovo".

